



**Është më mirë
kur je anëtar.**

**Ka shumë arsye për të qenë
pjesë e IG Metall.**



IG Metall: Së bashku për një jetë të mirë.

Do të doje të ardhura të drejta,
kushte të mira puna dhe më shumë
drejtësi? Edhe ne.

Një jetë e mirë është një punë e mirë.

Ne – IG Metall: Me mbi 2,1 milionë anëtarë jemi gjithmonë të angazhuar për një punë të mirë. Sepse puna është një element integral i jetës sonë. Për të mundur një jetë të mirë, nevojitet fuqia krijuese e një komuniteti të fortë.

Kontratat kolektive vendosin standarde

Dëshiron kushte të rregulluara dhe të drejtën për t'i pasur ato?

Rezultati ynë më i rëndësishëm janë kontratat kolektive. Ato rregullojnë kushtet e punës, si niveli i të ardhurave, koha javore e punës, e drejta për pushime dhe shpërblime, e drejta e punësimit pas formimit, e drejta për vazhdimin e trajnimeve dhe zhvillimit profesional, si dhe mundësia e fleksibilitetit për daljen në pension. Ato vlejné në industrinë metalurgjike dhe elektrike, në atë të hekurit dhe çelikut, në sektorët e tekstileve dhe të veshjeve, drurit dhe

plastikës, në sektorin e TIK-ut, si dhe në profesioneve automobilistike dhe elektrike. Dhe ato nuk ndikojnë vetëm në kompanitë me kontrata kolektive, por vendosin standarde për gjithë industrinë.

 [igmetall.de/tarife](https://www.igmetall.de/tarife)

Mbrojtja ligjore § 27 e statutit të IG Metall

A dëshiron **këshillim dhe përfaqësim të mirë?**

Ne i përgjigjem të gjitha pyetjeve të tua rreth botës së punës. Kur bëhet fjalë për klasifikim të saktë, kontroll të kontratave të punës ose referencave apo në rastin më të keq kur bëhet fjalë për shkarkim nga puna, jemi pranë teje me këshilla dhe vepra. Në rast mosmarrëveshjes, ti si anëtar mund të marrësh në përfitosh prej nesh këshillim ligjor. Ne të përfaqësojmë jashtëgjyqësore dhe nëse është e nevojshme, sigurisht edhe në gjykatë, në të gjitha rastet e të drejtës së punës dhe të drejtës sociale! Ne të përfaqësojmë gjithashtu p.sh. edhe në raport me agjencinë e punës, kompanitë e sigurimit shëndetësor, sigurimin e pensioneve ose shoqatat profesionale.

 [igmetall.de/rechtsschutz](https://www.igmetall.de/rechtsschutz)

Mbështetja §§ 23 dhe 24 e statutit të IG Metall

A dëshiron të ndihmosh **së bashku me të tjerët në punën tonë?**

Ne të mbështesim në rast mosmarrëveshjes në punë: Këshillet tona të punës në IG Metall janë

të mirëtrajnuar në vend dhe e njohin situatën në kompani dhe angazhimi yt është shumë i nevojshëm. IG Metall është e domosdoshme në themelimin e këshilleve të punës si dhe në rast mosmarrëveshesh lidhur me kontrata kolektive. Nëse vjen puna deri tek greva, IG Metall u ofron anëtarëve të saj edhe ndihmë financiare sipas statutit.

 [igmetall.de/leistungen](https://www.igmetall.de/leistungen)

Shërbime të tjera §§ 26, 28, 30 e statutit të IG Metall

Nuk do doje që **solidariteti** të mbarojë tek porta e fabrikës?

Jemi pranë teje edhe në rast aksidentesh që ndodhin jashtë punës. **Sigurimi ynë kundër aksidenteve në kohën e lirë** është i vlefshëm në gjithë botën, pavarësisht faktit nëse aksidenti ndodh në shtëpi, në oborr apo në udhëtim: Qoftë nëse ndodh me makinë, motor ose biçiklete, sigurimi do të hyjë në fuqi nëse bëhet shtrim në spital për 48 a më shumë orë.

Emergjencat e jashtëzakonshme personale kërkojnë një mbështetje të shpejtë e të pakomplikuar financiare. Sigurisht, IG Metall ndihmon edhe në rast katastrofash që cenojnë ekzistencën e kompanisë, si përmytjet dhe katastrofat natyrore.

Dhe nëse ndodh më e keqja, vdekja, mbështesim edhe anëtarët dhe familjarët e tyre sipas statutit.

 [igmetall.de/leistungsrechner](https://www.igmetall.de/leistungsrechner)

Përditësohu vazhdimisht

A dëshiron **të informohesh dhe të përditësohesh?**

Ne ofrojmë informacione gjithëpërfshirëse lidhur me çështje të sindikatës dhe shoqërisë përmes broshurave tona, këshilltarëve tanë dhe në igmetall. de. Në seminarët tona, ofrojmë formim të mëtejshëm rreth politikave të kompanisë dhe sindikatës. Për shkëmbimin praktik kemi rrjete si për shembull, për gratë, studentët ose personat me kualifikim të lartë.

Revista e anëtarëve tanë **metall. Dein Magazin** të ofron çdo dy muaj informacione të përditësuara, raporte, artikuj dhe fakte interesante nga bota e punës.

Të gjitha shërbimet për anëtarët janë falas.

«Një punonjës i metalurgjisë varet nga anëtarësimi në IG Metall, nëse do të përfaqësohet në mënyrën e duhur dhe efikase në sferën sociale.»

Nga vendimi i Gjykatës Federale, shpallur më 10.12.1984,
II ZR 91/84

Ne. IG Metall.

Një sindikatë që prezantohet.

A do doje të dije më shumë rreth IG Metall? Revista jonë «Wir. Die IG Metall.» përcjell qartë atë që përfaqësojmë, atë që ofrojmë dhe se çfarë nënkupton sindikata. Përfshihet në çdo paketë informuese dhe mund të porositet falas në

➤ igmetall.de/infopakete



Bëhu menjëherë anëtar online në

➤ igmetall.de/beitreten

Të rrjetëzuar dhe të informuar.

Porosite broshurën tonë informuese në

➤ igmetall.de/info-service

Impressum

IG Metall
Wilhelm-Leuschner-Straße 79
60329 Frankfurt am Main

Verteten durch den Vorstand,
1. Vorsitzende Christiane Benner
Kontakt: vorstand@igmetall.de

V.i.S.d.P./ Verantwortlich nach § 18 Abs. 2 MStV:
2. Vorsitzender Jürgen Kerner

www.igmetall.de

Titelfoto: IG Metall

Stand: Juli 2024

PN: 1000784A

Albanisch